



Datë: 16.06.2025
Numër Protokoli: 4133/2025

A.nr.889/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari, kryetare, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani anëtar, me Driton Jashari, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurës sipas ankesës me numër A.nr.889/2025, të datës 15.05.2025, të parashtruar nga ankuesja V.K, kundër organit të punësimit/Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me Nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, Nenin 16, paragrafi 3 dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 16.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

- I.** Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.889/2025, e datës 15.05.2025, e parashtruara nga ankuesja V.K.
- II.** Mbetet në fuqi Njoftimin i datës 20.03.2025, i Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja, V.K (referuar më tutje si ankuesja) me datë 15.05.2025 ka parashtruar ankesë, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës regjistruar nën shenjë A.nr.889/2025 e protokolluar me nr.3163/2025, kundër Njoftimit të datës 20.03.2025 të Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së. lidhur me procedurën e rekrutimit, Grupi i administrimit të përgjithshëm, Zyrtar për Regjistrim Civil, klasa e pozitës Profesional 2 me numër Reference RN00016720.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 26.05.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek MPB, ndërsa me datë 03.06.2025, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen administrative në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesa me nr. Protokoli 3163 e datës 15.05.2025; Njoftimin e datës 20.03.2025 NJMBNJ e MPB; Konkursin e datës 14.02.2025 me afat aplikimi nga 15.02.2025 deri me date 16.03.2025; Vendimin për themelimin e komisionit nr. protokoli 475 i datës

24.03.2025; Vendimin për shtyrje të afatit për verifikim paraprak me nr. protokolli 536 të datës 01.04.2025, Listën e kandidatëve të cilët i plotësojnë kriteret e përgjithshme të datës 11.04.2025; Listën e renditjes përfundimtare të kandidatëve; Aplikacioni i ankueses i datës së aplikimit 13.03.2025 ora 08:24.

Kolegji i Këshillit, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave, nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se Ministria e Punëve të Brendshme me datë 14.02.2025 ka bërë njoftimin publik për shpalljen e konkursit për pozitën Zyrtar për Regjistrim Civil në Kamenicë, klasa e pozitës Profesional 2 - Grupi i Administrimit të Përgjithshëm, ku afati për aplikimi ka qenë i hapur nga data 15.02.2025 deri me date 16.03.2025, ndërsa kërkesat e përgjithshme formale kanë qenë:

Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) në Arsimi i lartë i paspecifikuar.

Përvoja e punës e kërkuar: së paku 1 (një) vit përvojë pune në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës

Nga shkresat e lëndës konstatohet fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesja, mirëpo të njëjtës përmes Njoftimit të datës 20.03.2025 Njësia e Burimeve Njerëzore të MPB ia ka refuzuar aplikacionin me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit, respektivisht NUK ka dorëzuar dëshmi së paku 1 (një) vit përvojë punë në fushën për të cilën zhvillohet procedura për pozitën e lirë, me rastin e aplikimit. Ndërsa, nga shkresat e lëndës të dërguar nga organi punëdhënës arrihet në konstatim se ankuesja nuk ka dorëzuar dëshmi së paku 1 (një) vit përvojë punë ashtu siç është kërkuar në konkurs por vetëm pasqyrën e llogarisë së Trustit për pagimin e kontributeve.

Tutje, sipas shkresave të lëndës Kolegji i Këshillit konstatoi se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të MPB-së, përmes njoftimit të datë 20.03.2025 ia ka refuzuar ankueses aplikacionin, me arsyetimin se e njëjta nuk i ka plotësuar kriteret edhe kërkesat e përcaktuara sikurse në konkursin e datës 14.02.2025, ngase nuk ka dorëzuar dëshmi së paku 1 (një) vit përvojë punë, gjatë aplikimit ashtu siç është kërkuar tek kriteret formale të konkursit të lartpërmendur .

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon se i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara sipas konkursit dhe për këto ka dorëzuar dëshmi, duke cekur në veçanti se gjatë aplikimit ajo ka dorëzuar vetëm pasqyrën e llogarisë së Trustit për pagimin e kontributeve, pa dorëzuar dëshmi për përvojën e punës, ashtu siç kërkohet në konkursin e shpallur nga MPB. Në ankesën e saj ajo ka bashkangjitur vetëm pasqyrën e llogarisë së Trustit, e cila sipas kërkesave në konkurs konsiderohet vetëm si dokument mbështetës e dëshmisë për përvojën e punës.

Kolegji i Këshillit konstaton se ankuesja me rastin e aplikimit në konkursin RN00016720 nuk ka kompletuar aplikacionin ashtu siç e kërkojnë dispozitat ligjore.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankueses, Kolegji i Këshillit mori për bazë shpalljen e konkursit të datës 14.02.2025 me numër reference shifër RN00016720 dhe konstatoi se sipas pikës 5 të konkursit, Dokumentet që duhet të dorëzohen si pjesë e aplikimit dhe mënyrën e dorëzimit të tyre, ndër të tjerash ishte kërkuar edhe: “*Kopjet e dëshmisë së punësimit*

(vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmitë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështet së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal. Përvoja e punës, e cila deklarohet sipas kushteve të konkursit, e fituar në një shtet tjetër, dëshmohet përmes dëshmisë së përkthyer mbi përvojën e punës të lëshuar nga organi kompetent i atij shteti, apo përmes dëshmisë së përkthyer dhe noterizuar për përvojës të lëshuar nga punëdhënësi përkatës.

Ndërsa nga shkresat e administruara të ofruara nga organi punëdhënës dhe deklarimi i ankueses në ankesën e saj, konstatohet se ankuesja nuk ka bashkëngjitur dëshmi për përvojën e punës siç është përcaktuar në pikës 5 të konkursit të datës 14.02.2025 me numër reference shifër RN00016720 e cila duhet të dëshmojë përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë, por ka bashkëngjitur vetëm pasqyrën e llogarisë së Trustit për pagimin e kontributeve, e cila konsiderohet dëshmi mbështetëse e kopjes së dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit, dhe mbi këtë bazë

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankueses, ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të nenit 6 paragrafi 2 nën paragrafi 2.2, ndërlidhur me nenin 7 paragrafi 1 të Rregullores Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se: “6.2. Së bashku me aplikacionin për pjesëmarrje në procedurën e rekrutimit, kandidatët duhet të bashkëngjisin edhe dokumentacionin në vijim: 2.1. kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs e të dhëna nga institucionet arsimore, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar jashtë vendit apo aktin që dëshmon se diploma e fituar jashtë vendit është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë; 2.2. **kopjet e dëshmisë së punësimit**; 2.3. kopjet e dokumenteve që provojnë plotësimin e kushteve për aplikim të përcaktuara në shpalljen e rekrutimit dhe të deklaruara në aplikacion.; 7.1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidatët për pranim në shërbimin civil plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit.”.

Kolegji i Këshillit, duke shqyrtuar aplikacionin e ankueses, ankesën e ankueses dhe përgjigjeje në ankesë të MPB-së, dhe duke u bazuar në përcaktimet sipas dispozitave ligjore të cekura më lartë konstaton se ankuesja nuk ka plotësuar kriterin formal sipas kërkesave të konkursit RN00016720.

Kurse sa i përket pretendimit të ngritur nga ankuesja, se disa nga kandidatët të cilët kanë kaluar fazën e verifikimit paraprak, nuk kanë plotësuar kriterin e përvojës së punës dhe se nuk kanë as një ditë përvojë pune por kanë kontrata të cilat i kanë bërë në momentin e aplikimit dhe nuk punojnë fare në vendet ku kanë bërë kontrata, janë këshilluar dhe favorizuar nga zyrtarët e komisionit të cilët më apo pa qëllim të përfitimit personal, kanë favorizuar disa kandidat të cilët janë në listë. Për këto pretendime ankuesja deklaron në ankesën e saj se ka bërë kallëzim penal në Prokurorinë Themelore në Prishtinë.

Kolegji i Këshillit vlerëson së ky pretendim ankimor tejkalon autorizimet kushtetuese dhe ligjore të Këshillit, kurse pala ankuese ka vepruar drejt për trajtim të këtyre pretendimeve në procedurë kompetente penale.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: *Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.889/2025

Driton JASHARI

Procesmbajtës

Malsore Gashi BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses V.K;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MPB;
- Arkivit të KPMSHCK-së.